

VENDIM
Nr. 85, datë 6.2.2026

**PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E
EKONOMISË MALORE NË BASHKINË KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e maleve”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” në territorin e Bashkisë Krujë të zonave, si më poshtë vijon:

a) Zona nr. 1, zonat Barkanesh, Dane – Fushë Madhe, Bojë, pjesë e Njesisë Administrative Krujë, me sipërfaqe 1258.65 (një mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë pikë gjashtëdhjetë e pesë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto;

b) Zona nr. 2, Njësia Administrative Cudhi, me sipërfaqe 7712.62 (shtatë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e dy) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto;

c) Zona nr. 3, zonat Picërragë, Brret, Gjyre, Abaze, Krastë, Mali i Krujës, pjesë e Njesisë Administrative Krujë, me sipërfaqe 1917.76 (një mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto;

ç) Zona nr. 4, zonat Halil, Virjon, Nikël, Zezë, Kurcaj, Buran, Mukaj, pjesë e njësive administrative Fushë-Krujë dhe Nikël, me sipërfaqe 2424.28 (dy mijë e katërqind e njëzet e katër pikë njëzet e tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto;

d) Zona nr. 5, zonat Budull, Bubq, Mazhë-Madhe, Mallkuç, pjesë e Njesisë Administrative Bubq, me sipërfaqe 1920.2 (një mijë e nëntëqind e njëzet pikë dy) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto.

2. Shtrirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes së këtyre zonave përcaktohen në hartën treguese, sipas sistemit KRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve që do të zhvillohen në këtë zonë janë:

a) të zhvillimit ekonomik;

b) të zhvillimit industrial;

c) të zhvillimit turistik.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Zona 1. Barkanesh, Dane - Fushë Madhe, Boje , ZK 1118 dhe 8621, Njesia Administrative Krujë



SH 1: 25,000




HARTA E PAKETËS MALEVE, BASHKIA KRUJË

- Zona 2. Njësia Administrative Cudhi me 10 fshatrat e saj, ZK 1425, ZK 1290, ZK 3218, ZK 2809, ZK 3398 dhe ZK 2547



Sipërfaqja e përgjithshme e zonës është S = 7712.62 Ha;

SH 1: 50, 000




HARTA E PAKETËS MALEVE, BASHKIA KRUJË

Zona 3.Picrraqë, Brret, Gjyre, Abaze, Krastë, Mali i Krujës, ZK 8622, ZK 2957 dhe ZK 8621, Njesia Administrative Krujë



Sipërfaqja e përgjithshme e zonës është **S = 1917.76 Ha;**

SH 1: 50, 000




HARTA E PAKETËS MALEVE, BASHKIA KRUJË

Zona 4. Halil, Verjon, Nikël, Zezë, Kurcaj, Bura, Mukje ZK 1042, ZK 1921, ZK 3908, ZK 2734, ZK 3783, ZK 2795 Njësia Administrative Fushë Krujë dhe Nikël



Sipërfaqja e përgjithshme e zonës është S = 2424.28 Ha;

SH 1: 30, 000



HARTA E PAKETËS MALEVE, BASHKIA KRUJË

Zona 5. Budull, Bubq, Mazhe e Madhe, Mallkuç ZK 1299, ZK 1294, ZK 2621, ZK 2577, Njësia Administrative Bubq



Sipërfaqja e përgjithshme e zonës është S = 1920.2 Ha;

SH 1: 25, 000

